



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 23.5.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi dhe Etem Arifi.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtarët nga MMPH, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 3.5.2011 dhe 10.5.2011.
3. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistratit të të drejtave të pronës së paluajtshme.
4. Shqyrtimi i projektligjit për Kadastër.
5. Shqyrtimi i propozimit për një kandidat në komisionin shqyrtues në ZRRUM.
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 3.5.2011 dhe 10.5.2011

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluara pa ndonjë vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme

Kryesuesi Nait Hasani sugjeroi krijimin e grupit punues i cili do të shqyrtoi projektligjin dhe në fund i sjellë rekomandimet komisionit, ku përfundimisht marin bekimin e komisionit. Grupi punues do të jetë : **Salih Morina**-kryesues, anëtarët **Etem Arifi** dhe **Afërdita Berisha**. Grupit punues do ti bashkëngjitet edhe konsulenti **Arsim Avdijaj** me mbështetjen e NDI, i cili do të ndihmoi GP gjatë shqyrtimit të projektligjit.

4. Shqyrtimi i projektligjit për Kadastër

Po ashtu edhe për këtë projektligj kryesuesi **Nait Hasani** ftoi anëtarët e komisionit për grupin punues që do të shqyrtoi këtë projektligj, ndaj u vendos si vijon : **Liburn Aliu**-kryesues, **Nijazi Idrizi** dhe **Sevdije Lama** anëtarë, të cilët do të shqyrtojnë projektligjin bashkërisht me z. Avdiu dhe ekspertët eventual.

Të dy kryesuesit u dakorduan me z. Avdiu për të premtën me pas një takim të shkurt në pauzën e mbledhjes plenare, kur do të mirën vesh për caktimin e takimeve të grupeve punuese, pasi që z. Avdijaj do të bëjë përgatitjet e duhura.

Në vazhden e kësaj, kryesuesi propozoi që komisioni gjithashtu të deklarohet për projektligjin për verëra, i cili ka hy në procedurën parlamentare, komisioni nxori këtë :

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim në mbledhjen plenare, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për Verëra.

5. Shqyrtimi i propozimit për një kandidat në komisionin shqyrtues në ZRRUM

Kryesuesi Nait Hasani fillimisht sqaroi dispozitat ligjore në bazë të cilave një kandidat për komisionin shqyrtues në ZRRUM propozohet nga ky komision. Dispozitat ligjore nuk saktësojnë sa kandidat duhet të janë ose kushte tjera. **Salih Morina** ishte i mendimit se dy apo ma tepër kandidat të propozuar do të ishte më mirë dhe më meritor, ndërkaq **Afërdita Berisha** tha se ndoshta më mirë do të ishte të jetë jurist. Pasoj shpjegimi i kryesuesit i cili tha se shkencat politike përfshijnë edhe këtë lëmi. Pasi që **Liburn Aliu** kërkoi një takim paraprak me kandidatin e ofruar, komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohet i njëjti për bisedë.

6. Të ndryshme

Nijazi Idrizi tha se projektligji për verëra, i cili ka ardhur në shqyrtim, kërkon angazhimin e komisionit edhe në teren sidomos në Suharekë dhe Rahovec, mirëpo pas sugjerimeve që u dëgjuan, kjo çështje mbeti të diskutohet pasi të krijohet grupi punues për këtë projektligj.

Nait Hasani dhe **Afërdita Berisha** cekën dy kërkesa të dy kompanive në privatizim (Gjeravica në Deçan dhe Ballkani në Suharekë) për një takim të mundshëm me komisionin, pasi që nuk janë të kënaqën me privatizimin e këtyre dy ndërmarrjeve.

Salih Morina inicioi vizitën në dy ministritë, ndërsa **Liburn Aliu** arsyetoi këtë, përveç tjerash, edhe për shkak të eksploatimeve të zhavorrit, ngase siç tha ai, “askush nuk po ju afrohet këtyre për ti ndaluar në eksploatimin e rërës, bile edhe policia po sulmohet nga këta eksploatues”. Komisioni u pajtua si në vijim :

1. Të vizitohet MMPH më 25 maj 2011- ministri dhe zyrtarët kompetent të departamenteve, por paraprakisht të konsultohet ora e takimit me zyrën kompetente në atë ministri (sugjerimi i komisionit : diku rreth orës 11,00), dhe
2. Të vizitohet MBPZHR më 26 maj 2011- ministri dhe zyrtarët kompetent të departamenteve, të cilët gjithashtu do të konsultohen për orën e takimit (diku rreth orës 11,00 sipas sugjerimit të komisionit)

Lidhur me vazhdimin e vizitave të komisionit nëpër komuna, komisioni u pajtua të vizitohet **Komuna e Kamenicës më 30 maj 2011**, për të cilin ditë stafi do të njoftoi kryetarin e komunës, departamentet përkatëse për bujqësi e mjedis të cilët do të ftojnë në këtë takim edhe ndonjë OJQ ose fermer. Nisja nga Kuvendi në orën 9,00.

Mbledhja e radhës u caktua për 30 maj 2011 në orën 8,30 kur do të shqyrtohet lista e ekspertëve të komisionit : stafi do të dërgoj anëtarëve të komisionit listën e ofruar nga Kuvendi, ndërsa anëtarët e komisionit eventualisht do të bashkëngjisin listës ndonjë ekspert shtesë. Kandidati i propozuar për komisionin shqyrtues në ZRRUM do të ftohet nga kryesuesi për mbledhjen e radhës.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 11,40.

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani